

Burim Ramadani: Mbi gjysmë milioni euro në muaj për pagat e të emëruarve politikë të LV-së | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ÇFARË NËSE KOSOVA MBETET PA PRESIDENT PAS 4 TETORIT?

| FAQE 4-5



Më 4 tetor përfundon periudha gjashtëmujore gjatë së cilës, sipas Kushtetutës, pozitën e presidentit të Kosovës mund ta mbajë një ushtrues detyre. Albulena Haxhiu, kryeparlamentare e legjislaturës së dhjetë të Kuvendit të Kosovës, filloi ta

ushtrijë detyrën e presidentes më 4 prill, kur Vjosa Osmanit i mbaroi mandati pesëvjeçar në krye të shtetit. Si rezultat i mosarritjes së një konsensusi mes partive politike parlamentare për emrin e presidentit të ardhshëm të Kosovës, vendi shkoi

në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Kuvendi i dalë nga votimet e 7 qershorit ka mbetur pa u konstituuar pavarësisht prej kalimit të afatit kushtetues. Subjektet politike duken ende larg një marrëveshjeje për presidentin

BORDI I SHSKUK-së KËRKON MASA PËR FURNIZIMIN ME BARNA DHE ELIMINIMIN E LISTAVE TË PRITJES NË KLINIKA | F. 7



NGËRÇI INSTITUCIONAL: TOPI ËSHTË TE PARTIA FITUESE, TË GJITHA JUSTIFIKIMET PËR MOSKONSTITUIMIN E KUVENDIT JANË TË PAQËNDRUESHME | F. 3



AKTUALE




TRUMPI PROVOKON IRANIN, PUBLIKON HARTËN KU HORMUZI SHËNOHET SI TERRITOR I SHBA-së | F. 2

'MIQTË E AMERIKËS' FESTOJNË 80-VJETORIN E ISH-PRESIDENTIT CLINTON ME ZJARRFIKËSIT E PRISHTINËS | F. 7

SHTETASI IRANIAN KËRKON AZIL NË KOSOVË | F. 6

EKONOMI



DORËZOHET CERTIFIKATA E PARË E ORIGJINËS E NJOHUR NDËRKOMBËTARISHT | F. 8

FIM DHE ATK NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI | F. 8

SPORT



KOMBËTARJA U21 ZHVILLON STËRVIJTJEN E PARË PARA NISJES PËR 'TARANTO 2026' | F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net


INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

GODITJA NDAJ PLATFORMËS SË NJOHUR TË YOUTUBE-it NË IRAN SINJALIZON KUFIZIME TË REJA

TEHRAN, 19 GUSHT - Autoritetet iraniane kanë ndërmarrë masa kundër platformës së njohur online Azad, duke e akuzuar atë për publikimin e “të pavërtetave” dhe duke sinjalizuar atë që një aktivist dhe komentator politik iranian e cilëson si një goditje më të gjerë ndaj kanaleve të pavarura në gjuhën perse në YouTube. Veprimi erdhi vetëm dy ditë pasi “The New York Times” publikoi një profil të Azadit, duke vënë në pah audiencën në rritje të platformës me bazë në Teheran dhe rolin e saj në organizimin e debateve mbi çështje që rrallë diskutohen në mediet iraniane të kontrolluara nga shteti. Megjithatë, nuk ka asnjë të dhënë që raportimi i “Times” ta ketë nxitur veprimin e autoriteteve. Ndërkohë, vendimi ka nxitur kritika nga gazetarë dhe figura të botës së medias, të cilët kanë vënë në pikëpyetje arsyen përse autoritetet shënjestrojnë një platformë që ka pritur të ftuar me pikëpamje që variojnë nga kritika të forta ndaj Republikës Islamike deri te mbështetja për establishmentin klerikal. Mehdi Ahmadi, themeluesi dhe drejtori i Azadit, tha më 17 gusht se ishte thirrur në një zyrë të prokurorisë lidhur me akuzat për përhapjen e informacioneve të rreme dhe ishte liruar me kusht. Ai tha se platformës i ishte ndaluar

publikimi i intervistave deri në një njoftim tjetër. Prokurorët e Teheranit kanë paraqitur gjithashtu një kallëzim kundër personave të përfshirë në program. Agjencia e lajmeve e gjyqësorit, Mîzan, e përshkroi Azadin si një “media të paligjshme”, duke thënë se ajo nuk kishte licencë zyrtare nga Bordi Mbikëqyrës i Shtypit dhe Medias të Iranit dhe Ministria e Kulturës. Prokurorët e akuzuan Azadin për kryerjen e shkeljeve të shumta mediatike, por nuk dhanë hollësi. Hossein Razzagh, një aktivist politik iranian i cili vetë është ndaluar për veprimtari në mediet online, tha se goditja ishte e parashikueshme. “Prej kohësh ishte parashikuar se Azad përfundimisht do të bëhej objekt i goditjes së Republikës Islamike”, tha Razzagh për Radio Farda të Radios Evropa e Lirë. Ai iu referua ndalimit të mëhershëm të aktivistit Mehdi Mahmoudian i cili kishte qenë i përfshirë në një tjetër program në YouTube, Studio Pat. Razzagh tha se Azadi fillimisht ishte përpjekur të ruante një ekuilibër në programet e saj, por u bë më kritik pas goditjes së përgjashme ndaj protestave në janar dhe luftës pasuese amerikano-izraelite kundër Iranit. Mijëra persona u vranë ndërsa autoritetet shtypën protestat

mbarëkombëtare në janar. Ndërsa grupet iraniane të të drejtave të njeriut me bazë jashtë vendit thonë se kanë verifikuar rreth 7 000 vdekje, ato thonë se numri real i viktimave ka gjasa të jetë më i lartë. Razzagh tha se koha kur u ndërmor veprimi kundër Azadit ishte domethënëse, sepse programet në gjuhën persiane në YouTube kanë qenë duke fituar audiencë, ndërsa shpejtësitë e internetit janë përmirësuar dhe shikuesit gjithnjë e më shumë u janë drejtuar burimeve alternative të informacionit. Transmetuesi shtetëror i Iranit nuk ka qenë në gjendje të tërheqë të njëjtat audiencia, tha Razzagh, ndërsa kanalet në YouTube të krijuara nga institucionet e sigurisë ose grupet e lidhura me qeverinë gjithashtu kanë hasur vështirësi në krijimin e një audience masive. “Ndalimi i Azadit mund të jetë një dritë e kuqe, një paralajmërim për mediat e tjera dhe platformat e tjera online që prodhojnë përmbajtje kritike ndaj qeverisë”, tha ai. YouTube, sikurse shumica e platformave të tjera të njohura të mediave sociale, është e ndaluar në Iran dhe mund të qaset vetëm përmes programeve proxy. Azad operon që nga viti 2022, duke organizuar diskutime



politike, ekonomike dhe sociale me ekspertë dhe komentatorë iranianë brenda dhe jashtë vendit. Kanali i saj në YouTube ka gati 160.000 abonentë, ndërsa llogaria e saj në Instagram ka më shumë se 30.000 ndjekës. Platforma ka pritur të ftuar me pikëpamje shumë të ndryshme, përfshirë mbështetës të përfundimit të Republikës Islamike përmes një referendumi kushtetues, përkrahës të rikthimit të monarkisë dhe individë që mbrojnë politikën e shtetit. Sipas Ahmadit, Azad ishte gjithashtu e përfshirë në organizimin e një interviste me komentatorin konservator amerikan Tucker Carlson dhe presidentit Masud Pezeshkian. Ahmadi i tha The New York Times se ai ia kishte propozuar

intervistën Carlsonit dhe më pas e kishte rekomanduar atë te ekipi i presidentit iranian. Razzagh tha se përdorimi i akuzës për “përhapjen e të pavërtetave” u mundëson autoriteteve ta paraqesin veprimin si një çështje të zakonshme penale, në vend se si një përpjekje për të shtypur mospajtimin. “Ata duan të luajnë një lojë me dy anë: të thonë se nuk po i mbyllin zërat kritikë, ndërkohë që po i mbyllin”, tha ai. Ai paralajmëroi se veprimi mund të shënojë fillimin e një fushate më të gjerë kundër mediave të pavarura online. “Nëse mediat e tjera të pakta që kanë mbetur dhe që prodhojnë përmbajtje të pavarur nuk i nënshtrohen heshtjes që Republika Islamike dëshiron të imponojë, edhe ato do të bëhen objektiv”, tha Razzagh.

TRUMPI PROVOKON IRANIN, PUBLIKON HARTËN KU HORMUZI SHËNOHET SI TERRITOR I SHBA-së

WASHINGTON, 19 GUSHT - Ngushtica e Hormuzit, territor i ri i Shteteve të Bashkuara. Donald Trump nuk tërhiqet nga ideja e tij, por së fundi e çoi edhe më tej provokimin ndaj Iranit duke publikuar në rrjetet sociale një hartë ku rruga strategjike ujore paraqitet si pjesë e ShBA-së. Ngushtica, përmes së cilës kalon rreth 20 për qind e naftës në botë,

ndodhet në ujërat territoriale të Iranit dhe Omanit. Idenë e aneksimit të saj, Trump e hodhi për herë të parë të premtën, dhe me sa duket, po vazhdon t'i mëshojë, pavarësisht indinjatës së regjimit të ajatollahëve. “Ne e kontrollojmë atë përmes bllokadës dhe më pëlqen ideja për ta shpallur territory amerikan. Po nxjerrim miliona



fuçi naftë në javë” përmes Ngushticës së Hormuzit,

Çmimet e naftës po bien dhe rënia do të vazhdojmë nëse vendosim të bëjmë diçka shumë më drastike se ajo që po bëjmë aktualisht”, ishte mesazhi i tij. Irani i cilësoi të tilla deklarata si iluzione. “ShBA-ja nuk e pranon realitetin e humbjes”, tha zëvendësministri i Jashtëm iranian, Kazem Gharibabadi, që këmbënguli se është Republika

Islamike që vazhdon ta mbajë në fakt të bllokuar ngushticën dhe ka në dorë fatin e saj. Teherani kërkon gjithashtu respektimin e kritereve të marrëveshjes së arritur me Iranit dhe Shteteve të Bashkuara, si kusht për rihapjen e kanalit ujqor nga ku kalon 20 % e furnizimeve globale me gaz dhe naftë.

Sulmet ukrainase e shtyjnë Moskën t'i forcojë lidhjet e mbrojtjes me Azinë Qendrore

KIEV, 19 GUSHT - Presidenti rus Vladimir Putin ka nënshkruar direktiva për ndryshimin e marrëveshjeve për bashkëpunimin ushtarako-teknik me Kazakistanin dhe Uzbekistanin, duke hapur potencialisht rrugën për lidhje më të thella në fushën e mbrojtjes me këto dy shtete të Azisë Qendrore. Teksa sanksionet perëndimore dhe sulmet ukrainase me rreze të gjatë

veprimi po e vënë nën presion industrinë ushtarake të Rusisë, kjo lëvizje mund të sinjalizojë se Moska po kërkon të zhvendosë një pjesë të bazës së saj ushtarako-industriale për të zvogëluar cënueshmërinë ndaj sulmeve. Pasi Putini nënshkroi direktivat muajin e kaluar, Kremlini nuk ka bërë të ditur se çfarë ndryshimesh kërkon të bëjë në marrëveshjet, të cilat mbulojnë furnizimin dhe

mirëmbajtjen e armëve dhe pajisjeve ushtarake, si dhe forma të tjera të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes. Që nga hyrja në fuqi e marrëveshjes me Kazakistanin në vitin 2015 - pas nënshkrimit fillestar në Moskë në vitin 2013 - Astana ka blerë një sërë pajisjesh ushtarake ruse, përfshirë aeroplanë luftarakë, helikopterë dhe sisteme të mbrojtjes ajrore.

Ngjashëm, marrëveshja e vitit 2016 me Uzbekistanin zgjeroi bashkëpunimin ushtarako-teknik me dy vendeve, ndërsa Tashkenti bleu helikopterë rusë sulmues, transportues të blinduar të personelit dhe dronë taktikë. Yermek Seitbattal, një analist ushtarak kazak i specializuar në çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë, tha se koha kur është ndërmarë ky vendim vë në pah presionin



ndërkombëtar në rritje ndaj Moskës.

NGËRÇI INSTITUCIONAL: TOPI ËSHTË TE PARTIA FITUESE, TË GJITHA JUSTIFIKIMET PËR MOSKONSTITUIMIN E KUVENDIT JANË TË PAQËNDRUESHME

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 GUSHT - Profesori universitar, Ibrahim Gashi, ka reaguar të mërkurën në lidhje me situatën politike në vend. Gashi ka shkruar në "Facebook" se partia fituese ka përgjegjësinë ta udhëheqë procesin, por kërkimi i një marrëveshje me opozitën për zgjedhjen e presidentit pa u bërë më parë hapi i parë, konstituimi i Kuvendit, nuk është qasja e duhur. "Marrëveshja politike ka kuptim në fazën e formimit të Qeverisë, sepse aty bëhet fjalë për bashkëpunim dhe ndarje të përgjegjësiave të pushtetit. Duke qenë se vendi së shpejti do të përballet edhe me zgjedhjen e presidentit, atëherë një marrëveshje e tillë duhet të ndërtohet me atë parti opozitare që ka numrat e nevojshëm për ta bërë të mundur zgjedhjen e presidentit", ka shkruar Gashi.

Ai ka thënë se rruga duhet të jetë e qartë. Fillimisht konstituimi i Kuvendit, pastaj formimi i qeverisë përmes një marrëveshje politike për stabilitetin institucional, përfshirë edhe zgjedhjen e presidentit. "Rezultati zgjedhor duhet respektuar, por 53 deputetë nuk mjaftojnë për të qeverisur pa partnerë. Kjo nuk e zbeh fitoren e partisë së parë; përkundrazi, e vendos atë përballë përgjegjësisë për të ndërtuar kompromisin e nevojshëm. Kosova nuk ka nevojë për marrëveshje të improvizuara për poste. Ka nevojë për një marrëveshje politike që zhblokon institucionet dhe garanton stabilitetin e shtetit. Këtë ende nuk po e shohim. Aktualisht topi është tek partia fituese nëse ajo nuk lëviz me konstituimin e parlamentit. Të gjitha justifikimet e saj janë të paqëndrueshme dhe përgjegjësia bie mbi të. Sigurisht në fazën e zgjedhjes së

presidentit përgjegjësia mund të bie edhe mbi partitë tjera, por jo këtë fazë", ka shkruar Gashi. Edhe ish-zëvendëskryeminstria Edita Tahiri ka reaguar në lidhje me zhvillimet në vend. Ajo ka shkruar në "Facebook" se zbatimi i kushtetues është prioritet, pastaj vijnë ndarja e pushtetit mes pozitës dhe opozitës. "Çka i ndodhi LDK-së shtetbërëse që injoron shkeljen e kushtetutës nga partia fituese. LDK-ja ka qenë konsekuente për parimet e kushtetutës që nga koha kur e themeluan në kohë të rënda historike", ka shkruar Tahiri. Në lidhje me situatën në vend ka reaguar edhe deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, e cila ka kritikuar partinë fituese dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti. Bajrami ka thënë se Kosova rrezikon të shkojë sërish në zgjedhje pasi, sipas saj, Kuvendi nuk po konstituohet pa një marrëveshje politike për

zgjedhjen e presidentit. Ajo ka kritikuar arsyetimet për moskonstituimin e Kuvendit, duke i cilësuar si "banale", ndërsa ka thënë se ato po e mbajnë Kosovën pa institucione legjitime që nga dhjetori i vitit 2024. "Që tri herë zgjedhje, për të shkuar prapë në zgjedhje. Pse? Nga 's'bën qerrja para kalit', deri te 'nuk e konstituojmë Kuvendin pa marrëveshje politike, sepse nëse e bëjmë vendi shkon në zgjedhje' - janë arsyetimet me banale të cilat nga dhjetori i vitit 2024 po e mbajnë Kosovën pa institucione legjitime. E derisa kjo sagë vazhdon dhe tolerohet, nuk ka pothuajse asnjë sferë të jetës në Kosovë që nuk ka degraduar, asnjë të vetme. Tash thonë: 'nuk e konstituojmë Kuvendin pa marrëveshje për Presidentin, sepse nëse s'ka marrëveshje, vendi shkon në zgjedhje'. Po nëse nuk e konstituoni Kuvendin, vendi prapë shkon në zgjedhje. Atëherë, çfarë po përpiqeni të

shmangni? Prandaj, sot secili qytetar i Kosovës ka të drejtë të pyesë: Çka po do Albin Kurti? Pse po e shtyn vendin vazhdimisht drejt zgjedhjeve? Kujt i shërben një Kosovë pa Kuvend funksional dhe pa institucione legjitime? Që tri herë po shkojmë në zgjedhje, për të përfunduar përsëri në zgjedhje. Pse?", ka shkruar Bajrami në "Facebook". Kosova mbajti zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare më 7 qershor 2026, të cilat ishin zgjedhjet e tretat me radhë brenda një periudhe të shkurtër pas krizave politike. Edhe pse vendi doli nga procesi zgjedhor, ngujimi politik po vazhdon. Aktualisht ende nuk ka asnjë marrëveshje politike mes partive për krijimin e institucioneve të reja. Këto vonesa të njëpasnjëshme po rrisin tensionet politike dhe, në mungesë të një kompromisi, po e çojnë vendin sërish në drejtim të zgjedhjeve të reja të jashtëzakonshme parlamentare.

Shtetasi iranian kërkon azil në Kosovë

PRISHTINË, 19 GUSHT - Një shtetas iranian ka kërkuar azil në Kosovë, pasi është ndaluar në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Sipas njoftimit të Policisë së Kosovës, gjatë kontrollit më 18 gusht, i dyshuari kishte paraqitur një pasaportë të lëshuar nga Belgjika. Gjatë intervistimit ai e kishte pranuar se dokumenti nuk ishte i tij dhe kishte deklaruar se ishte shtetas iranian, pa

dokumente personale me vete. Ai u kishte thënë autoriteteve se ndihej i kërcënuar në Iran. Drejtori i Qendrës për Azil, Fitim Zariqi, konfirmoi për Radio Evropë e Lirë se shtetasi iranian e ka dorëzuar kërkesën për azil. "Ka parashtruar kërkesë për azil edhe shqyrtohet kërkesa prej Ministrisë së Punëve të Brendshme", tha Zariqi. Sipas tij, shqyrtimi i kërkesës mund

të zgjasë deri në gjashtë muaj, me mundësi vazhdimi edhe për tre muaj të tjerë. "Po zakonisht nuk zgjat më shumë se mesatarisht dy muaj e gjysmë, apo tre", tha ai. Nuk dihet se nga cili vend kishte udhëtuar shtetasi iranian drejt Kosovës. Radio Evropë e Lirë është në pritje të përgjigjeve nga Policia e Kosovës për rrethanat e udhëtimit, statusin e rastit dhe nëse ai po ndiqet penalisht.



ÇFARË NËSE KOSOVA MBETET PA PRESIDENT PAS 4 TETORIT?



PRISHTINË, 19 GUSHT - Më 4 tetor përfundon periudha gjashtëmujore gjatë së cilës, sipas Kushtetutës, pozitën e presidentit të Kosovës mund ta mbajë një ushtrues detyre.

Albulena Haxhiu, si kryeparlamentare e legjislaturës së dhjetë të Kuvendit të Kosovës, filloi ta ushtronte detyrën e presidentes më 4 prill, kur Vjosa Osmanit i mbaroi mandati pesëvjeçar në krye të shtetit. Si rezultat i mosarritjes së një konsensusi mes partive politike parlamentare për emrin e presidentit të ardhshëm të Kosovës, vendi shkoi në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Kuvendi i dalë nga votimet e 7 qershorit ka mbetur pa u konstituuar, me gjithë kalimin e afatit kushtetues për një gjë tilla, teksa subjektet politike duken ende larg një marrëveshjeje për presidentin.

Çfarë nëse kreu i ri i shtetit të Kosovës nuk zgjidhet deri më 4 tetor? Kush do ta udhëheqë Kosovën pas kësaj date?

Interpretimet janë të ndryshme, e një situatë e tillë nuk është paraparë nga akti më i lartë juridik në Kosovë - Kushtetuta.

Njohës të zhvillimeve politike e juridike në Kosovë konsiderojnë se nuk ka bazë kushtetuese që vendi të vazhdojë të udhëhiqet nga një ushtrues i detyrës së presidentit pas përfundimit të periudhës gjashtëmujore.

Por, në Lëvizjen Vetëvendosje - parti e cila i fitoi zgjedhjet e fundit - vlerësojnë se pozitën do të mund ta ushtronte kryetari i ri i Kuvendit deri në zgjedhjen e presidentit të ri.

Eugen Cakolli, hulumtues në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), thotë për Radion Evropa e Lirë se periudha gjashtëmujore për ushtrimin e detyrës së presidentit përbën afat absolut dhe, si i tillë, nuk mund të përsëritet në asnjë skenar.

Moszgjedhja e presidentit të ri deri më 4 tetor, sipas Cakollit, përbën skenarin më të rrezikshëm kushtetues me të cilin mund të ballafaqohet Kosova. “Në një situatë të tillë, vendi do të hynte në një terren kushtetues, i cili, përveçse do të ishte serioz dhe i rrezikshëm, do të duhej medoemos të kishte parashtrësë në Gjykatën Kushtetuese”, shprehet ai.

Melos Kolshi, hulumtues ligjor në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), thotë për Radion Evropa e Lirë se pas 4 tetorit çdo vazhdim i ushtrimit të detyrës së presidentit do të ishte pa bazë kushtetuese dhe do ta cenonte seriozisht rendin kushtetues.

Ai konsideron se mungesa e presidentit me mandat kushtetues nuk është çështje formale - duke theksuar rolin që presidenti e ka në funksionimin dhe në formimin e institucioneve, në përfaqësimin e vendit, në

sigurinë dhe mbrojtjen, dhe në procedurat e tjera që Kushtetuta ia rezervon kreut të shtetit.

“Mungesa e një personi që ka bazë kushtetuese për t’i ushtruar këto kompetenca do ta vendoste vendin përballë një krize të re institucionale dhe kushtetuese, për të cilën Kushtetuta nuk ofron një mekanizëm të qartë zgjidhjeje”, thotë ai.

LV: Ushtrues të ri të detyrës së presidentit deri në zgjedhjen e tij

Situata shihet ndryshe në LV.

Deputeti i LV-së në Kuvendin e Kosovës, Adnan Rustemi, thotë se pozita e ushtruesit të detyrës së presidentit është e varur nga pozita e kryetarit të Kuvendit.

Sipas tij, pas zgjedhjes, kryetari i ri i Kuvendit nis ushtrimin e detyrës së presidentit deri në zgjedhjen e presidentit. Afati prej gjashtë muajsh, i përcaktuar nga Kushtetuta, nis të rrjedhë nga fillimi, me zgjedhjen e kryetarit të ri të Kuvendit, thotë ai. “Është në frymën dhe përmbajtjen, por edhe në funksionin e Kushtetutës, që të garantojë vazhdimësi institucionale. Asnjëherë, e për asnjë arsye, vendi nuk mund të mbetet pa president apo pa ushtrues detyre të presidentit. Vakum institucional nuk mund të ketë në asnjë rrethanë”, deklaroi Rustemi për Radion Evropa e

Lirë.

Cakolli nga KDI thotë se interpretimi që afati gjashtëmujor automatikisht ripërtërihet me zgjedhjen e kryetarit të ri të Kuvendit nuk qëndron në aspektin kushtetues.

Ai vlerëson se kjo do të ishte edhe e rrezikshme, pasi do të relativizojë rëndësia e zgjedhjes së presidentit. “Në qoftë se do të mund të zgjidhnim një kryetar Kuvendi, kurdo që është në prag të skadimit të afatit gjashtëmujor, do të kishim vetëm ushtrues detyre të presidentit në vazhdimësi, e që, si e tillë nuk është ideja e as qëllimi pse ekzistojnë dispozitat kushtetuese në fjalë”, thotë Cakolli.

Sipas Kolshit nga IKD, afatet kushtetuese nuk mund të trajtohen si afate orientuese, ndërsa Kuvendi nuk mund ta normalizojë vendimmarrjen jashtë tyre. “Nëse, megjithatë, arrihet në situatën kur përfundon afati gjashtëmujor, ndërsa presidenti i ri nuk është zgjedhur, atëherë kemi një paqartësi serioze”, thotë ai.

Në kërkim të një marrëveshjeje për presidentin, LV-ja nuk ka propozuar kandidatin e saj për kryetar të ri të Kuvendit, duke lënë pezull konstituimin e legjislaturës së 11-të, që do t’i hapte rrugë edhe formimit të qeverisë së re. Mungesa eventuale e një presidenti të zgjedhur pas 4 tetorit, sipas Cakollit, do të

pamundësonte shumë procedurë që duhet të ndiqen.

Përveç se vendi do të mbetej pa komandant suprem të ushtrisë, e pa organin që balancon pushtetet, Cakolli thotë se “nuk do të kishim instancë as për ta dekretuar mandatarin e ri për pozitën e kryeministrit, e aq më pak që të merren veprime që kanë të bëjë me, ta zëmë, çështjen e shpalljes së zgjedhjeve eventuale e të tjera”.

Ndërkohë, në debat është ngritur edhe çështja e afatit 60-ditor për zgjedhjen e presidentit, i cili nis vetëm pas konstituimit të Kuvendit.

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, tha për mediat se brenda kësaj periudhe partitë duhet “të gjejnë kandidatin që është i pranueshëm për të gjitha palët”.

Cakolli thotë se moskonstituimi i Kuvendit brenda afatit e ka krijuar një problem të dyfishtë me afatet kushtetuese: “Sa më shumë vonohet konstituimi, aq më shumë ky afat [60-ditor] shtyhet përtej 4 tetorit, kur përfundon afati gjashtëmujor i ushtruesit të detyrës së presidentit”.

Sipas tij, vonesa ia shkurton Kuvendit kohën që e ka në dispozicion për ta zgjidhur çështjen e presidentit para përfundimit të periudhës gjashtëmujore gjatë së cilës në vend të presidentit të zgjedhur mund të ketë ushtrues detyre.

KURTI DHE ABDIXHIKU BISEDONË PËR PROFILIN E PRESIDENTIT TË ARDHSHËM

PRISHTINË, 19 GUSHT - Kreu i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, kanë diskutuar për profilin potencial që do të duhet të ketë kreu i ri i shtetit. Pas takimit dyorësh që mbajtën një ditë më parë në ambientet e Kuvendit, si Kurti, ashtu edhe Abdixhiku, u shprehën se ka vullnet që dy partitë të arrijnë një pajtim për të gjetur një emër për presidentin. “Ne sot diskutuam hollësisht dhe thellësisht për kriteret, standardet që duhet të ketë figura presidenciale”, tha Kurti. Takimi, sipas Kurtit, u zhvillua në atmosferë pozitive, duke shtuar se ai pa vullnet te pala tjetër, që vendi të ketë një president të ri.

Ai tha se aktualisht nuk mund të flitet për emra konkretë. “Duam president ose presidente meritorë, kushtetuese, që reflekton vlerat e shoqërisë sonë, që ka kontribut për popullin e në profesion të caktuar, dhe në këtë mënyrë nuk ngjall dilema për rolin, për funksionin dhe për detyrën fisnike që do t'i duhet ta kryejë në pesë vjetët e ardhshme”, tha Kurti. Abdixhiku, ndërkaq, tha se dy partitë do të zhvillojnë diskutime brenda partive të tyre dhe në takimin e ardhshëm do të bisedojnë për emra konkretë. “Ka vullnet të dyanshëm se si duhet të duket presidenti i ri apo presidentja e re e vendit”, tha udhëheqësi i LDK-së. Abdixhiku shtoi se është i bindur

që mund të gjendet një figurë meritorë për postin e presidentit. Sipas LDK-së, presidenti i ri duhet të jetë një figurë që e do Republikën, e mbron atë dhe ushtron unitetin politik, ashtu siç kërkohet me Kushtetutë. Abdixhiku tha se për këto parime palët kanë gjetur pajtim. “Nuk duam një president të parëndësishëm, por një figurë e cila është e respektuar dhe ushtron me dinjitet funksionin më të lartë shtetëror. Jam i bindur se Kosova ka figura të tilla”, tha Abdixhiku, duke riktheksuar se partia e tij nuk kërkon asgjë mbrapsht, por vetëm “stabilitet institucional”. Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca kanë refuzuar disa ftesa të Kurtit për takime, por

udhëheqësi i LV-së tha se ende është i gatshëm të takohet me këto dy parti për çështjen e presidentit. “Por, rrethana në të cilën ndodhemi është rrethana e imponuar, dhe ku intensivisht kemi nisur bisedime shumë serioze LV-ja dhe LDK-ja” për çështjen e presidentit, tha Kurti. Ky takim i tyre vjen disa ditë pasi Abdixhiku njoftoi se nuk dëshiron marrëveshje politike me Kurtin për formimin e institucioneve të reja, por shtoi se është i hapur për mbështetjen e një kandidati konsensual, jopartiak për postin e kreut të shtetit. Pas këtij njoftimi të Abdixhikut, Kurti ka kërkuar që partitë të takohen dhe të flasin për emra konkretë për kreun e ri të shtetit. LV-ja e Kurtit dhe LDK-ja e

Abdixhikut kanë negociuar për një marrëveshje për bashkëqeverisje, por Abdixhiku hoqi dorë nga pjesëmarrja në ekzekutiv pasi tha se oferta e Kurtit nuk ishte e pranueshme për të. LDK-ja kishte kërkuar pozitën e presidentit dhe pjesëmarrje në qeveri, duke argumentuar se një gjë e tillë do të krijonte balancë institucionale, por Kurti i kishte ofruar udhëheqjen e tri ministrive dhe zëvendëskryeministrin, sipas Abdixhikut. Kosova ndodhet në një krizë të re institucionale pas zgjedhjeve të parakohshme të 7 qershorit. Kuvendi ende nuk është konstituuar, ndonëse afati 30-ditor për përfundimin e këtij procesi ka skaduar më 7 gusht.



“Nëse presidenti nuk zgjidhet dhe konsumohet edhe afati 60-ditor, krijohet një problem edhe më serioz sa i përket ushtrimit të kompetencës për caktimin potencial të zgjedhjeve, nëse ndërkohë ka përfunduar edhe afati kushtetues i ushtruesit të detyrës së presidentit”, thotë Cakolli. “Ky është rreziku që është krijuar nga vonesa. Kemi dy afate kushtetuese që tashmë nuk ecin më paralelisht dhe, në skenarin e dështimit të zgjedhjes së presidentit, mund ta çojnë vendin në një situatë për të cilën Kushtetuta nuk ofron një zgjidhje”, paralajmëron ai. Kolshi, ndërkaq, thotë se “afati maksimal gjashtëmujor për ushtrimin e detyrës së presidentit

është afat i veçantë, dhe nuk lidhet me afatin 60-ditor për zgjedhjen e presidentit”. “Pra, fillimi eventual i afatit 60-ditor nuk e zgjat dhe as nuk e pezullon afatin gjashtëmujor të ushtruesit të detyrës së presidentit”, thekson ai.

Cila do të ishte zgjidhja?

Sipas IKD-së dhe KDI-së zgjidhja për gjithë këtë situatë është që çështja të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese. Cakolli thotë se së paku dhjetë deputetë të Kuvendit të Kosovës, me kalimin e 4 tetorit, do të duhej të kërkonin nga Kushtetuesja që, së pari, të vendoste masë të përkohshme, dhe, së dyti, të

konstatonte se cili është efekti juridik i prodhuar nga dështimi i Kuvendit për të zgjedhur presidentin para skadimit të afatit gjashtëmujor të ushtrimit të detyrës. “Pastaj i mbetet Gjykatës që, qoftë bazuar në dokumentet përgatitore të Kushtetutës, apo edhe në bazë të opinioneve që mund të marrë nga vendet e tjera, të përcaktojë se çfarë ndodh tutje: a vijon kryetari i Kuvendit, apo ka ndonjë instancë tjetër që do ta marrë atë pozitë”, thotë ai. Përcaktimi i pasojave kushtetuese dhe i mënyrës së funksionimit të institucioneve në një situatë të tillë, edhe sipas Kolshit, do të duhej të ishte çështja kyç që do të definohej nga Gjykata Kushtetuese. “Prandaj, zgjidhja

duhet të kërkohet, para së gjithash, brenda afateve ekzistuese kushtetuese, përmes zgjedhjes së presidentit të ri. Lejimi që këto afate të kalojnë, pa zgjedhjen e presidentit, do ta fuste Kosovën në një territor kushtetues të paparashikuar, ku vazhdimi i ushtrimit të detyrës, përtej kufirit gjashtëmujor, nuk mund të justifikohet pa një bazë të qartë kushtetuese”. Sipas Rrustemit të LV-së, zgjidhja është zgjedhja e presidentit të ri, për të cilin, thotë ai, duhet të ketë dialog e marrëveshje politike. Lidhur me mandatin e ushtrueses së detyrës së presidentit dhe veprimet që duhet të ndiqen në rast të dështimit të zgjedhjes së presidentit të ri deri më 4 tetor,

Radio Evropa e Lirë pyeti edhe në Zyrën e Presidentit, por nuk mori përgjigje deri në publikimin e këtij teksti. Sipas Kushtetutës së Kosovës, presidenti zgjidhet nga Kuvendi me votim të fshehtë. Zgjedhja bëhet me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, apo me 80 vota nga 120 deputetë sa ka gjithsej Kuvendi i Kosovës. Procesi i zgjedhjes së presidentit mund të organizohet deri në tri votime. Nëse as në raundin e tretë - kur kërkohen 61 vota nga të paktën 80 deputetë të pranishëm në sallë - asnjëri nga kandidatët nuk i merr votat e nevojshme, Kuvendi shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e reja të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditësh.

Pas Ujmanit, edhe në Radoniq po rrënohen ndërtimet pa leje

PRISHTINË, 19 GUSHT - Ministria në detyrë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fitore Pacolli, ka qëndruar të mërkurën në zonën e Liqenit të Radoniqit në Gjakovë, ku Inspektorati Mjedisor ka nisur aksionin për rrënimin e disa objekteve të ndërtuara pa leje në pronë publike. Aksioni ishte paralajmëruar nga Pacolli mëngjesin e sotëm,

e cila kishte bërë me dije se do të udhëtonte drejt Gjakovës për ta përcjellë nga afër ndërhyrjen e institucioneve. “Rend dhe ligjshmëri në çdo cep të Kosovës!”, ka shkruar Pacolli. Ajo ka theksuar se qëllimi i aksionit është lirim i pronave publike nga uzurpimet dhe rikthimi i ligjshmërisë. “Aksioni ynë për vendosjen e

ligjshmërisë anembanë Kosovës do të vazhdojë dhe prona publike do të lirohet nga uzurpimet e paligjshme”, kishte deklaruar ministria. Pacolli ka publikuar pamje nga vendi i ngjarjes, duke bërë me dije se aksioni po zhvillohet në zonën e Liqenit të Radoniqit. Sipas saj, ndërhyrja në Gjakovë është pjesë e një aksioni më të gjerë të Inspektoratit Mjedisor

për rrënimin e objekteve pa leje të ndërtuara në prona publike. Pacolli tha se aksioni kishte nisur fillimisht në veri të vendit, ndërsa tash është shtrirë edhe në Gjakovë dhe do të vazhdojë në zona të tjera të Kosovës. “Ky aksion për rrënimin e objekteve pa leje në prona publike ka filluar në veri, sot po zhvillohet në Gjakovë dhe do të



vazhdojë edhe në pjesë të tjera të Kosovës”, tha Pacolli. Ministria e ka paraqitur aksionin si pjesë të përpjekjeve institucionale për vendosjen e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e pronës publike nga uzurpimet.

BURIM RAMADANI: MBI GJYSMË MILIONI EURO NË MUAJ PËR PAGAT E TË EMËRUARVE POLITIKË TË LV-së

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 GUSHT - Deputeti i Aleancës, Burim Ramadani, e ka akuzuar qeverinë për, siç ka thënë, “gjakderdhje financiare” përmes pagave të të emëruarve politikë. Në një konferencë për medie Ramadani ka deklaruar se 463 të emëruar politikë në qeverinë para 7 qershorit vazhdojnë të marrin paga nga buxheti i Kosovës, duke pretenduar se emërimet e tyre janë të jashtëligjshme. Sipas tij, shumua mujore e pagave për këta të

emëruar arrin në rreth 486 mijë e 150 euro, ndërsa me shpenzimet shtesë, si mbushjet e telefonave, përdorimi i veturave, karburantet dhe shpenzimet e reprezentacionit, shumua totale, sipas Ramadanit, e kalon gjysmë milioni euro në muaj. “Janë 463 të emëruar politikë në Qeverinë para 7 qershorit që marrin pagë nga populli i Kosovës në mënyrë të jashtëligjshme”, ka thënë Ramadani. Ai pretendoi se këta persona nuk kanë të drejtë të vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre



dhe se, sipas tij, nuk kanë të drejtë as të hyjnë në zyrat qeveritare. Ramadani ngriti akuza edhe

për mënyrën e emërimit të disa zyrtarëve, duke thënë se ka raste kur persona që kanë punuar shoferë janë emëruar këshilltarë politikë me qëllim të rritjes së pagës. Deputeti i Aleancës i bëri thirrje Prokurorisë së Shtetit t'i nisë menjëherë hetimet lidhur me këto pretendime. “Duhet të ndalet gjakderdhja financiare”, ka theksuar ai. Ramadani e krahasoi shumë prej mbi gjysmë milioni eurosh në muaj me pagat e 769 policëve, 862 pjesëtarëve të FSK-së, 909 zjarrfikësve ose 781 mësimdhënësve.

IPK REKOMANDON SUSPENDIMIN E DY POLICËVE LIDHUR ME PRETENDIMET PËR KEQTRAJTIMIN E NJË SERBI

PRISHTINË, 19 GUSHT - Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka rekomanduar suspendimin e dy zyrtarëve policorë pas pretendimeve për keqtrajtimin e një qytetari serb, të identifikuar vetëm me inicialet N. R. N. R. është identifikuar publikisht si Nenad Rashkoviç. IPK rekomandoi suspendimin e dy policëve nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicë të Veriut pasi dyshohet se janë përfshirë në veprën penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. IPK tha se rekomandimi u bë pas hetimit paraprak që kishte për qëllim verifikimin e pretendimeve dhe sqarimit të fakteve lidhur me veprimet

policore gjatë një operacioni të zhvilluar në Dren të Zubin Potokut. Hetimet nisën pas raportimeve mediale dhe deklaratave publike se më 11 gusht Nenad Rashkoviç ishte keqtrajtuar nga policia. Igor Simiq nga Lista Serbe ka reaguar ndaj vendimit të IPK-së, duke theksuar se “suspendimi nuk mjafton”. “Përgjegjësit duhet të japin llogari para gjykatës, sepse bëhet fjalë për torturë, keqtrajtim psikik dhe fizik, shkaktim të lëndimeve të rënda trupore, nxjerrje me dhunë të deklaratës... ndërsa ata që me gënjeshtër u përpoqën ta mbulonin këtë krim duhet të mbajnë përgjegjësi”, shkroi ai në rrjetet sociale. Rashkoviç është dërguar në



Beograd për trajtim të mëtejshëm për shkak të gjendjes shëndetësore, sipas Zllatan Ellek, drejtor i Qendrës Klinike Spitalore në Mitrovicë të Veriut. Ellek, që është kryetar i Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit - ishte pranuar në spitalin në Mitrovicë me marramendje dhe dridhje. Pas ekzaminimeve, sipas tij, është konstatuar se Rashkoviç ka pasur

lëndime në kokë dhe krahavar si dhe thyerje të brinjëve. Sipas versionit që Elek tha se ia kishte rrëfyer Rashkoviç, pjesëtarët e Policisë së Kosovës e kishin rrahur gjatë kontrollit të shtëpisë së tij dhe i kishin kërkuar të dorëzonte armë. Më pas, sipas tij, policët ishin larguar dhe ishin kthyer disa orë më vonë, kur dyshohet se e kishin dërguar në një pyll, e kishin lidhur për një pemë dhe e kishin rrahur sërish me një zorrë uji. Ndërkaq, më 11 gusht Lista Serbe ka publikuar fotografi ku pretendohet se shihet Rashkoviç i mavijsur në shpinë. Në komunikatë, Lista Serbe tha se ai ishte dërguar në pyll, ku ishte lidhur me një pemë dhe ishte

rrahur me një zorrë uji, me kërkesën që të pranonte se kishte kryer krime lufte ndaj shqiptarëve. Së voni, në Zubin Potok janë kryer kontrole dhe arrestime të personave të dyshuar për krime lufte, pasi në këtë komunë janë identifikuar disa lokacione ku dyshohet se mund të ndodhen varreza masive nga lufta e viteve 1998-'99 në Kosovë. Vetë Rashkoviç, për mediet në gjuhën serbe, kishte dhënë një version që dallonte në disa detaje nga ai i paraqitur nga Lista Serbe. Ai tha se, pasi ishte lidhur në pyll, policët e kishin liruar dhe se më pas ishte kthyer vetë në shtëpi. Sipas tij, në vendngjarje kishin qenë tre policë, por vetëm njëri prej tyre e kishte rrahur.

Gjykata mbyll shqyrtimin për vrasjen e trefishtë në Glllogjan, aktgjykimi më 24 gusht

PRISHTINË, 19 GUSHT - Gjykata Themelore në Pejë ka mbyllur sot shqyrtimin gjyqësor në rastin e vrasjes së trefishtë në Glllogjan, ndërsa aktgjykimi ndaj Halil, Kreshnik dhe Kastriot Mehmetajt do të shpallet më 24 gusht. Gjatë seancës së mërkurë të këtij rigjykimi gjykata ka administruar si provë edhe një videoincizim, në të cilin, sipas gjykatës, shihet Kreshnik Mehmetaj duke gjuajtur me armë në një bjeshkë të Deçanit. Pas administrimit të provave, shqyrtimi gjyqësor është

shpallur i mbyllur dhe çështja tashmë është në fazën e shpalljes së aktgjykimit, raporton kp. Ndërkaq, rasti ishte paraparë të përfundonte më 10 korrik, kur ishte planifikuar shpallja e aktgjykimit. Megjithatë, Gjykata Themelore në Pejë kishte vendosur ta rihapë shqyrtimin gjyqësor për administrimin e një prove shtesë. Tre të akuzuarit po gjykohen për vrasjen e trefishtë që ndodhi më 26 nëntor 2021, kur u qëllua me armë zjarri në drejtim të autobusit që po

qarkullonte në Glllogjan. Nga të shtënat mbetën të vrarë shoferi i autobusit, Gani Gjokaj, dhe dy nxënës 17-vjeçarë, L. H. dhe G. M., ndërsa një tjetër person, F. T., ishte plagosur rëndë. Në aktakuzë të Prokurorisë thuhet se objektivi i sulmit ishte shoferi i autobusit, tashmë i ndjeri Gani Gjokaj. Sipas Prokurorisë, familja Mehmetaj e konsideronte atë përgjegjës për vetëvrasjen e vajzës së tyre, Heroina Mehmetaj, që pretendohet se ka qenë motivi i krimit. Sipas aktakuzës, Kastriot

Mehmetaj i armatosur kishte dalë në rrugë para autobusit, duke u shtirur si i dehur, me qëllim që ta detyronte shoferin të ngadalësonte ose të ndalonte. Pas ngadalësimit të autobusit, ai, sipas Prokurorisë, kishte shtënë në drejtim të shoferit. Më tej, sipas aktakuzës, pas kryerjes së sulmit Kastriot Mehmetaj ishte larguar në drejtim të fshatit Shaptej, ku e priste me veturë Kreshnik Mehmetaj. Aktakuza ngarkon edhe Halil Mehmetajn se, në periudhën nga 14 qershori 2020 deri më



26 nëntor 2021, kishte nxitur dy djemtë e tij, Kastriot dhe Kreshnik Mehmetajn, për vrasjen e Gani Gjokajt, shoferin e autobusit, duke e fajësuar vazhdimisht atë për vetëvrasjen e vajzës së tij, Heroina Mehmetaj.

‘MIQTË E AMERIKËS’ FESTOJNË 80-VJETORIN E ISH-PRESIDENTIT CLINTON ME ZJARRFIKËSIT E PRISHTINËS

PRISHTINË, 19 GUSHT - Në një aktivitet simbolik të organizuar me rastin e 80-vjetorit të lindjes së ish-presidentit amerikan Bill Clinton, Shoqata “Miq të Amerikës” zgjodhi Brigadën e Zjarrfikësve të Prishtinës për t’i përcjellë urimet dhe mirënjohjen e popullit të Kosovës. Me këtë rast, drejtuesit e brigadës dhe përfaqësuesit e shoqatës vlerësuan bashkëpunimin ndër vite dhe kontributin e zjarrfikësve, ndërsa theksuan edhe lidhjen e veçantë të Kosovës me ish-presidentin Clinton dhe mbështetjen e tij për vendin.

Komandanti i Brigadës së Zjarrfikësve në Prishtinë, Malë Gashi, ka falënderuar Shoqatën “Miq të Amerikës” që zgjodhi këtë institucion për ta shënuar ditëlindjen e ish-presidentit

amerikan Bill Clinton.

Kryetari i Shoqatës “Miq të Amerikës”, Agim Rexhepi, ka theksuar se nuk është e rastësishme që për 80-vjetorin e lindjes së ish-presidentit Bill Clinton është përzgjedhur Brigada e Zjarrfikësve të Prishtinës. “Jorastësishjtë ju kemi zgjedhur juve, sepse me vite e me vite Brigada e Zjarrfikësve, ish-komandanti, komandanti aktual, si dhe ju të gjithë zjarrfikësit, s’keni hezituuar në asnjë rast kur ka pasur nevojë për ndonjë aktivitet, për ndonjë ndërhyrje. Ju keni bërë një punë të jashtëzakonshme. I keni bërë nder institucionit tuaj, i keni bërë nder komunës, i keni bërë nder shtetit, i keni bërë nder kombit”, ka thënë Rexhepi.

Gjithashtu, nga Kosova ish-presidentit Clinton iu dërgua



një letër mirënjohjeje dhe urimi për ditëlindje. “Është një bexh, është një fletëpalosje e aktivitetit të shoqatës, është një

dizajn i caktuar ku është letra edhe dizajni, edhe letra që do t’i dërgohet presidentit Clinton. Është një kartolinë ekskluzive

që ia kemi dedikuar për këtë aktivitet, sepse është jubile. Edhe çka është edhe më e veçanta: është një notes ku është fytyra edhe jubileu, edhe urimi ynë, mirëpo e kemi shpërndarë edhe një sasi të pinave - do t’ia çojmë zotëri Ilirit - që nuk ka qenë sasi e vogël”, ka thënë Rexhepi.

Ai ka theksuar se simbolika më e madhe e këtij urimi është mesazhi që i është përcjellë Clintonit në emër të popullit dhe shtetit të Kosovës. “Urimi ka shkuar në emër të popullit të Kosovës, shtetit të Kosovës, mirëpo kemi thënë: ‘Shqiptarët nuk harrojnë’. Mendoj që ky është mesazhi më i fuqishëm, më i miri, më i ndershmë edhe më i sinqerti çfarë kemi mundur t’i tregojmë presidentit Clinton”, ka thënë Rexhepi.

BORDI I SHSKUK-së KËRKON MASA PËR FURNIZIMIN ME BARNA DHE ELIMINIMIN E LISTAVE TË PRITJES NË KLINIKA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 GUSHT - Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK) ka mbajtur mbledhjen e pestë të rregullt në të cilën është shqyrtuar raportimi i drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, draft-rregulloret për organizimin e brendshëm të klinikave të QKUK-së si dhe zbatimimi i rekomandimeve të dala nga raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB). Gjithashtu, në kuadër të pikës “Të ndryshme” u shqyrtuan shkresa dhe kërkesa të ndryshme të adresuara për Bordin Drejtues.

Në fjalën hyrëse, kryesuesi i Bordit Drejtues të ShSKUK-së, dr. Faik Shatri, i falënderoi për pjesëmarrjen përfaqësuesit e Odës së Mjekëve të Kosovës, Odës së Farmacistëve të Kosovës, Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Kosovës, si dhe Shoqatës për të Drejtat e Pacientëve të Kosovës (PRAK).

Ai e vlerësoi pjesëmarrjen e tyre si vlerë të shtuar në punën e Bordit dhe si kontribut në forcimin e bashkëpunimit institucional dhe përfshirjen më të gjerë të aktorëve relevantë në diskutimet për zhvillimin e sistemit shëndetësor. Drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së njoftoi Bordin për aktivitetet dhe punën e zhvilluar në ShSKUK që nga mbledhja e fundit e Bordit Drejtues.

Në kuadër të bashkëpunimit me GIZ-in, drejtori njoftoi Bordin për aktivitetet që janë duke u



zhvilluar në funksion të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit të aktiviteteve të përbashkëta.

Gjithashtu, ShSKUK është duke zhvilluar diskutime me Bankën Botërore për mundësi të mbështetjes së aktiviteteve të ndryshme, në mënyrë të pavarur nga fondet e angazhuara në Ministrinë e Shëndetësisë.

Në këtë kuadër, me përfaqësuesit e Bankës Botërore janë diskutuar tri çështje, prej të cilave dy janë më afër realizimit.

Njëra prej tyre lidhet me kostimin e shërbimeve shëndetësore, për të cilën Banka Botërore ka paraparë mjete të dedikuara. Ky aktivitet pritet të fillojë me kostimin e shërbimeve në QKUK dhe më pas të shtrihet edhe në spitalet e përgjithshme.

Drejtori njoftoi se ShSKUK është duke monitoruar procesin e transferimeve të pacientëve dhe është duke zhvilluar konkurse për pozita të ndryshme udhëheqëse, ndërsa ky proces do të vazhdojë edhe me pozitat e infermierëve.

Në bashkëpunim me Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Kosovës, është punuar edhe për përcaktimin dhe harmonizimin e detyrave të infermierëve për profile të ndryshme. Gjithashtu, sipas informatave të Divizionit të Infermierisë, pritet që së shpejti, në bashkëpunim me Odën, të formohet një grup punues për mbikëqyrjen e jashtme të aspektit profesional të infermierisë.

Drejtori njoftoi Bordin edhe për punën që është duke u zhvilluar në hartimin e Statutit të QKUK-së. Sa i përket buxhetit, u theksua se ka vështirësi në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa ShSKUK ka adresuar kërkesat përkatëse për mbështetje dhe sigurimin e nevojave të domosdoshme.

Gjatë diskutimit mbi raportimin e drejtorit të përgjithshëm, anëtarët e Bordit Drejtues u interesuan veçanërisht për gjendjen e furnizimit me barna dhe material mjekësor si dhe për masat që po

ndërmerren për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe për t’i shmangur mungesat gjatë vitit 2027.

Në këtë kuadër, Bordi kërkoi përgatitjen e një raporti mbi transferimet e pacientëve si dhe një raport të veçantë lidhur me funksionimin e shërbimit të biopsisë së veshkës në kuadër të Patologjisë.

Bordi kërkoi që për mbledhjen e ardhshme të përgatitet Raporti i Auditimit për procesin e furnizimit me barna dhe material mjekësor si dhe raportet për gjendjen aktuale të institucioneve bazuar në pyetësorët e dërguar më herët nga Bordi Drejtues.

Ndër kërkesat e tjera të Bordit ishte edhe përgatitja e raportit mbi ecurinë e implementimit të shërbimit të trajtimit të Strokut si dhe hartimi i një plani pune nga klinikat që kanë lista të pritjes, me qëllim të eliminimit të tyre.

Gjithashtu, Bordi kërkoi që të përgatitet dhe të paraqitet Raporti gjashtëmujor i punës së ShSKUK-së i cili do të ofrojë një pasqyrë të

përgjithshme mbi aktivitetin dhe performancën e shërbimeve shëndetësore gjatë gjysmës së parë të vitit.

Në vijim, anëtarët e Bordit shqyrtuan draft-rregulloret për organizimin e brendshëm të klinikave të QKUK-së. Pas shqyrtimit dhe diskutimeve, Bordi kërkoi që draft-rregulloret të harmonizohen me draft-Statutin e ri të QKUK-së dhe më pas të rikthehen për shqyrtim dhe miratim në Bordin Drejtues.

Në kuadër të shqyrtimit të zbatimit të rekomandimeve të dala nga raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), Bordi Drejtues kërkoi përgatitjen e një plani veprimi për implementimin e të gjitha rekomandimeve të pazbatuara deri në fund të vitit, me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit dhe forcimit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm në ShSKUK.

Në pikën e fundit të rendit të ditës, Bordi Drejtues shqyrtoi kërkesat dhe shkresat e ndryshme të adresuara nga njësitë organizative të ShSKUK-së dhe mori vendimet dhe konkluzionet përkatëse.

Në përmbyllje, kryesuesi i Bordit Drejtues, dr. Faik Shatri, theksoi se Bordi do të vazhdojë të fokusohet në rritjen e efikasitetit të ShSKUK-së, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, forcimin e llogaridhënies dhe kontrollit të brendshëm si dhe në krijimin e mekanizmave që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve dhe kujdesit ndaj pacientëve.

Zëvendësauditori i Përgjithshëm: Prokurimi publik mbetet sfidë në menaxhimin e financave publike

Prishtinë, 29 gusht - Zëvendësauditori i përgjithshëm, Beza Halilaj, mori pjesë në tryezën e organizuar nga Iniciativa për Progres - INPO, ku u paraqit raporti “Prokurimi që mbetet në plan”. Pjesëmarrësit diskutuan gjetjet e raportit, sfidat e identifikuara në procesin e planifikimit dhe zbatimit të prokurimit publik si dhe mundësitë për

përmirësimin e këtyre proceseve. Duke iu referuar rezultateve të auditimeve për vitin 2025, Halilaj tha se dobësitë nuk kufizohen vetëm në fazën e tenderimit, por në masë të konsiderueshme shfaqen edhe pas nënshkrimit të kontratave, veçanërisht në menaxhimin e tyre dhe përdorimit të e-Prokurimit. Prandaj, duhet

vëmendje e veçantë nga organizatat buxhetore, institucionet mbikëqyrëse dhe mekanizmat e kontrollit, theksoi ai. Ai tregoi se gjetjet që Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka identifikuar në prokurimin publik janë: dobësi në menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e kontratave përmes e-Prokurimit; mangësi



në planifikimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit; si dhe mangësi në

parakushtet, dokumentacionin dhe zbatimin e kontratave /projekteve.

DORËZOHET CERTIFIKATA E PARË E ORIGINJËS E NJOHUR NDËRKOMBËTARISHT

PRISHTINË, 19 GUSHT - Zëvendësministri i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Jeton Mehmeti, ka marrë pjesë në ceremoninë e dorëzimit të certifikatës së parë të origjinës me standarde ndërkombëtare për një produkt të prodhuar në Kosovë. Pas pranimit të Odës Ekonomike të Kosovës në Rrjetin Ndërkombëtar të Dhomës Ndërkombëtare të

Tregtisë (ICC) dhe akreditimit të saj në qershor të vitit 2026 për lëshimin e Certifikatave të Origjinës, është lëshuar certifikata e parë me standarde ndërkombëtare për kompaninë FLUIDI Group për vajin e lulediellit. Certifikata e origjinës përfaqëson më shumë se një dokument që shoqëron një produkt. Ajo dëshmon identitetin dhe origjinën e produktit si dhe standardet dhe cilësinë e punës



së prodhuesve vendorë. Njëkohësisht, përbën një hap konkret drejt rritjes së besuesh-

mërisë së produkteve të Kosovës, zgjerimit të eksporteve dhe forcimit të pranisë së tyre në tregjet globale. Në këtë proces diaspora vazhdon të mbetet një urë e rëndësishme lidhëse e Kosovës me tregjet ndërkombëtare dhe një partner i rëndësishëm për investime, eksporte dhe zhvillim ekonomik. Përmes lidhjeve të saj me bizneset dhe tregjet e huaja, diaspora mund të luajë rol të rëndësishëm në krijimin e

partneriteteve të reja dhe në hapjen e mundësive për prodhuesit e Kosovës. Lëshimi i certifikatës së parë të origjinës me standarde ndërkombëtare për një produkt vendor paraqet kështu një hap të rëndësishëm në procesin e ndërkombëtarizimit të prodhimit të Kosovës dhe në promovimin e identitetit “Made in Kosova”, si shenjë e cilësisë, besueshmërisë dhe potencialit të produkteve vendore.

FIM DHE ATK NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PRISHTINË, 19 GUSHT - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM) i Universitetit të Prishtinës dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me qëllim forcimin e bashkëpunimit institucional dhe ndërlidhjen e ekspertizës akademike me nevojat profesionale të ATK-së. Një numër i studentëve të FIM-it tashmë janë në përfundim të praktikës profesionale me pagesë në ATK. Gjatë kësaj peri-

udhe studentët kanë dëshmuar profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjshmëri në kryerjen e detyrave që u janë besuar, duke krijuar një përvojë të vlefshme profesionale. Marrëveshja parasheh bashkëpunim në fushën e ekspertizës inxhinierike, vlerësimit të aseteve dhe përgatitjes së raporteve teknike, si dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta profesionale, trajnuese dhe akademike. Marrëveshja është nënshkruar



nga prof. Mirlind Bruci, dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës, dhe Mentor Hyseni, drejtor i Përgjithshëm i

Administratës Tatimore të Kosovës. Në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për bashkëpunimin dhe mbështetjen e ofruar ndaj studentëve të FIM-it, drejtorit të përgjithshëm të ATK-së, Mentor Hyseni, iu dhurua trofeu i FIM-it, i punuar nga studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike. Ky bashkëpunim përbën një mundësi të rëndësishme për studentët e FIM-it që njohuritë akademike t'i ndërlidhin me

përvojën praktike si dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe institucioneve publike. Ky bashkëpunim shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e partneritetit ndërmjet FIM-it dhe institucioneve publike, duke krijuar mundësi për studentët, stafin akademik dhe institucionet që përmes dijes, ekspertizës dhe përvojës së përbashkët të kontribuojnë në zhvillimin profesional dhe institucional.

VAZHDOJNË KONTROLLET PËR PRODUKTET E QUMËSHTIT, IQMT KRYEN 23 INSPEKTIME

PRISHTINË, 19 GUSHT - Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT) ka njoftuar se inspektimet në treg po vazhdojnë në mënyrë intensive, me fokus të veçantë te produktet e qumështit, për shkak të mospërputhjeve të evidentuara në raportin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV). Gjatë inspektimeve në terren ekipet e IQMT-së kanë hasur produkte të cilat, sipas raportit

të AUV-it, rezultojnë me mospërputhje. Ndër produktet e evidentuara janë: Schmand VITA, 18% - 180 g; Schmand VITA, 18% - 400 g; Schmand VITA, 18% - 800 g; Mushroom Cream Cheese - 200 g; Mazë tradicionale DRENA - 1 kg; Holla Cooking Cream - 1 L; Qumësht MY COW - 3.2%; Mazë tradicionale MILKET - 800 g; dhe Schmand AJKA - 500 g. Ndërkohë, ekipet e IQMT-së kanë realizuar edhe riinspek-



time në disa markete, të cilat ditë më parë ishin urdhëruar për tërheqjen e produkteve të

qumështit që, sipas raportit të AUV-it, rezultojnë me mospërputhje. Gjatë këtyre riinspektimeve është verifikuar se operatorët ekonomikë kanë respektuar urdhëresat e IQMT-së dhe kanë ndërmarrë masat e kërkuara për tërheqjen e produkteve nga tregu. Vetëm gjatë 24 orëve janë realizuar 23 inspektime në komunat: Gjilan, Prishtinë, Pejë, Ferizaj, Gjakovë, Podujevë dhe

Mitrovicë. IQMT-ja ka bërë me dije se inspektimet në terren do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe garantimit të respektimit të legjislacionit në fuqi. Në të njëjtën kohë Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) u ka bërë thirrje konsumatorëve të vazhdojnë të raportojnë çdo parregullsi lidhur me produkte të dyshimta.

Shoqata “DITË” i bashkohet Odës Ekonomike të Kosovës me rreth 200 anëtare

PRISHTINË, 19 GUSHT - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Luzim Rafuna, ka pritur në takim përfaqësueset e Shoqatës së Grave “DITË”, e cila i është bashkuar zyrtarisht Odës Ekonomike të


Kosovës. Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin, krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e sipërmarrjes, fuqizimin ekonomik të grave si dhe përfaqësimin më të

fuqishëm të interesave të anëtareve të shoqatës. Me rreth 200 anëtare, Shoqata “DITË” sjell një kontribut të rëndësishëm në komunitetin e biznesit dhe në avancimin e rolit të grave në ekonomi.

Oda Ekonomike e Kosovës i uron mirëseardhje Shoqatës “DITË” dhe shpreh bindjen se ky partneritet do të krijojë mundësi të reja për bashkëpunim, zhvillim dhe fuqizim të grave në biznes.



LUFTA HIBRIDE: INTELIGJENCA ARTIFICIALE E SHNDËRRON INFORMACIONIN NË NJË FUSHËBETEJË



Nga Alessandro CONTE

Tridhjetë e tetë artikuj pro-rusë, të prodhuar me ChatGPT dhe të publikuar në faqe interneti të Afrikës së Jugut nën emra të sajuar. Është një nga episodet e rindërtuara në raportin e vitit 2026, kushtuar dobësisë së informacionit. Një rast i kufizuar, por domethënës: për të zhvilluar një fushatë ndikimi nuk nevojiten më redaksi të mëdha klandestine. Mjaftojnë qasja në një sistem të inteligjencës artificiale, disa ndërmjetës dhe një rrjet platformash të gatshme të publikojnë përmbajtje pa verifikuar origjinën. Raporti i vendos këto fenomene në kuadrin e “manipulimit dhe ndërhyrjes së huaj në informacion”, të njohur me akronimin FIMI, si edhe të operacioneve të ndikimit të kryera nga aktorë të huaj. Dezinformimi bëhet kështu një komponent i luftës hibride: ai shoqëron presionet ekonomike, sulmet kibernetike dhe nismat diplomatike armiqësore, me synimin për të orientuar debatin, delegjitimuar institucionet dhe thelluar përçarjet e brendshme. Hetimi i Forbidden Stories mbi Afrikën e Jugut ka dokumentuar pagesa ndaj ndërmjetësve të ngarkuar me promovimin e narrativave të favorshme për

Moskën, përmes influencerëve dhe mediave lokale. Inteligjenca artificiale ka siguruar lëndën e parë, duke përshpejtuar prodhimin e teksteve në dukje gazetareske. Pikërisht këtu ndodh ndryshimi i vërtetë: një person i vetëm mund të furnizojë disa faqe, të simulojë identitete të ndryshme dhe t’ua përshtatë të njëjtin mesazh audiencave të ndryshme, me kosto minimale.

Lufta hibride: Fushatat zgjedhore përbëjnë terrenin më të ndjeshëm

Fushatat zgjedhore përbëjnë terrenin më të ndjeshëm. Gjatë zgjedhjeve të parakohshme japoneze të vitit 2026, sipas një hetimi të Nikkei, 55 për qind e shikimeve të videoeve politike u gjeneruan nga krijues anonimë. Mungesa e një identiteti të verifikueshëm ua bën të pamundur zgjedhësve të rindërtojnë interesat, financimet dhe lidhjet ndërkombëtare që qëndrojnë pas tyre. Një video mund të arrijë miliona njerëz përpara se autoritetet, platformat apo gazetarët të arrijnë të përcaktojnë se kush e ka prodhuar. Në Hungari, manipulimi ka marrë një formë edhe më agresive. Deepfake dhe video

shpifëse kundër liderit të opozitës kishin grumbulluar rreth 650 milionë shikime në YouTube dhe Facebook. Qarkullimi i tyre është përforcuar edhe nga media pranë qeverisë. Kështu, falsifikimi digjital i ka kapërcyer kufijtë e rrjeteve sociale, duke hyrë në qarkun tradicional mediatik dhe duke fituar një dukje legjitimiteti. E njëjta dinamikë shfaqet edhe në konfliktet e armatosura. Gjatë përplasjeve kufitare mes Tajlandës dhe Kamboxhias, platforma të ndryshme u mbushën me imazhe të nxjerra jashtë kontekstit, rindërtime pa burime dhe mesazhe nacionaliste. Krijuesit dhe të vetëquajturit “gazetarë qytetarë” kanë zënë hapësirën e lënë bosh nga burimet zyrtare, duke e shndërruar çdo episod ushtarak në material për të ushqyer frikën dhe armiqësinë. Në një krizë, shpejtësia shpesh shpërblen përmbajtjen më emocionale, jo atë më të saktën. Deepfake-et dhe “AI slop”, vërshimi i materialeve sintetike me cilësi të dobët, të prodhuara në seri, e ndërllojnë edhe më shumë punën e redaksive. Në Evropën Perëndimore, shqetësimi për përdorimin politik të inteligjencës artificiale është rritur me nëntë pikë në Belgjikë dhe me tetë në Vendet e Ulëta. Problemi nuk lidhet vetëm

me cilësinë e falsifikimeve. Mbi të gjitha, rëndësi ka vëllimi i tyre: verifikimi i një fotografie kërkon kohë, ndërsa gjenerimi i njëqind të tillave kërkon vetëm pak minuta. Disa media po ndërtojnë struktura të posaçme. Transmetuesi danez DR ka nisur “DR Verify”, RTÉ e Irlandës ka krijuar shërbimin “Clarity”, ndërsa Thai PBS përdor që prej vitit 2025 platformën “Verify”, të përdorur gjatë tensioneve në kufirin kamboxhian. Në Tajvan, shërbimi publik TBS po eksperimenton me një chatbot të aftë të lidhë përgjigjet me burime të autorizuar gazetareske. BBC dhe mediat suedeze këmbëngulin, ndërkohë, te parimi “human in the loop”: asnjë përmbajtje e asistuar nga inteligjenca artificiale nuk duhet të publikohet pa kontroll editorial. Përgjigjja përfshin gjithashtu marrëveshje politike dhe mjete rregullatore. Në Norvegji, partitë kryesore janë angazhuar të mos përdorin deepfake gjatë zgjedhjeve. Në Spanjë, El País bashkëpunon me Maldita.es, ndërsa qeveria ka njoftuar krijimin e HODIO, një sistem të bazuar në inteligjencën artificiale për të monitoruar përhapjen e urrejtjes dhe polarizimit online. Singapori ka zgjedhur rrugën legislative me Online Safety Bill,

duke zgjeruar mbrojtjen ndaj dëmeve të shkaktuara nga përmbajtjet e manipuluar. Megjithatë, mbetet një dobësi strukturore. Besimi global te lajmet ka rënë në 37 për qind, ndërsa i ashtuquajturit “Google Zero” po zvogëlon trafikun e drejtpërdrejtë drejt faqeve të lajmeve: përgjigjet sintetike të integruara në motorët e kërkimit i mbajnë përdoruesit brenda tyre, pa i çuar te burimet origjinale. Si pasojë, publiku ndeshet me më pak përmbajtje të verifikuar dhe me më shumë narrativa të shpërndara nga krijues anonimë, sisteme automatike dhe rrjete të koordinuara. Një sinjal më pak i zymtë vjen nga përdoruesit e chatbot-eve: 44 për qind klikojnë lidhjet e propozuara për të kontrolluar besueshmërinë e përgjigjeve. Është një skepticizëm i dobishëm, por jo i mjaftueshëm. Vija e ardhshme e frontit do të kalojë nga aftësia për t’i bërë të dallueshme burimet, autorët dhe përmbajtjet sintetike. Nëse kjo gjurmueshmëri do të mbetet fakultative, inteligjenca artificiale do të vazhdojë t’u ofrojë operacioneve të ndikimit pikërisht atë që u nevojitet më shumë: shpejtësi, anonimitet dhe qasje të menjëhershme te opinione publike tashmë të përçara. / *European Affairs – Bota.al*

IRANI GATI TË GODASË EVROPËN NËSE TRUMP PËRSHKALLËZON LUFTËN



Irani po shqyrton mundësinë e goditjes së objektivave ushtarake amerikane në Evropë nëse presidenti Donald Trump urdhëron një përshkallëzim të ri të konfliktit, sipas burimeve pranë regjimit iranian të cituara nga Financial Times. Sipas dy personave të afërt me regjimin, forcat iraniane kanë analizuar mundësinë e sulmeve ndaj aseteve amerikane në vende të Evropës Juglindore, përfshirë Bullgarinë, e cila muajin e kaluar miratoi përdorimin e bazës ajrore Bezmer për avionët amerikanë të furnizimit me karburant. Një prej burimeve tha se në skenarët e mundshëm të hakmarrjes është përfshirë edhe Qiproja, ku një bazë ushtarake britanike u godit nga një dron në mars.

Teherani kërcënon me zgjerimin e konfliktit

Sipas burimeve të Financial Times, Ushtria iraniane ka shqyrtuar gjithashtu mundësinë e sulmeve ndaj kabllove nënujore të fibrave optike në ngushticën e Hormuzit, në rast të një përshkallëzimi të ri.

Këto zhvillime vijnë në një klimë gjithnjë e më të tensionuar në Teheran, ku një pjesë e regjimit po e konsideron rifillimin e luftës me SHBA-të si një çështje kohe. Situata është komplikuar edhe më tej pas forcimit të krahut konservator në strukturat e sigurisë dhe ushtrisë iraniane. Ndërkohë, Trump deklaroi të martën se nuk ka bisedime apo negociata të planifikuara me Teheranin. Garda Revolucionare dhe komandantë të tjerë ushtarakë iranianë kanë paralajmëruar se në një konflikt të ri të shkallës së gjerë, Teherani mund të zgjerojë objektivat përtej bazave amerikane dhe infrastrukturës në Lindjen e Mesme.

Evropa mund të bëhet pjesë e konfliktit

Sipas njërit prej burimeve, nëse SHBA-të godasin infrastrukturën iraniane, përgjigjja e Teheranit mund të shtrihet përtej Lindjes së Mesme. “Irani do të mbrohet me çdo çmim”, tha burimi, duke paralajmëruar se një përshkallëzim i madh mund ta çojë konfliktin deri në Evropë.

Ekspertët, megjithatë, vlerësojnë se kapacitetet iraniane për të goditur objektiva në distanca të mëdha janë reale, por të kufizuara. Sipas studiuesit Sidharth Kaushal të Royal United Services Institute, Irani mund të përdorë raketa balistike me rreze të mesme veprimi kundër objektivave amerikane në Evropën Jugore dhe Juglindore, por efektiviteti i tyre bie me rritjen e distancës. Ekspertët të tjerë theksojnë se Irani mund të përdorë edhe grupe aleate në rajon për të realizuar sulme indirekte, një strategji që Teherani e ka përdorur prej vitesh.

Irani ka tentuar të godasë objektiva në distanca të largëta

Teherani ka demonstruar më parë synimin për të goditur objektiva shumë larg territorit të tij. Pas nisjes së konfliktit mes SHBA-ve dhe Izraelit, Washingtoni e akuzoi Iranin për lëshimin e disa raketave drejt Diego Garcia, bazës ushtarake amerikano-britanike në Oqeanin Indian, rreth 4 mijë

kilometra larg Iranit. Raketa të tilla nuk arritën objektivin. Në mars, Turqia deklaroi se sistemet e mbrojtjes ajrore të NATO-s kishin interceptuar disa raketa balistike të lëshuara nga Irani. Në të njëjtën periudhë, baza britanike në Akrotiri të Qipros u godit nga një dron, për të cilin zyrtarët perëndimorë dyshuan se mund të ishte iranian, megjithëse sulmi mund të ishte kryer nga grupe aleate të Teheranit në rajon. Sipas burimeve iraniane të cituara nga Financial Times, një sulm i muajit të kaluar ndaj një baze amerikane në Jordani, ku u vranë tre ushtarakë amerikanë, ishte një nga operacionet më të sakta të Iranit në distanca të largëta.

Diplomacia në ngërç

Kërcënimet e reja vijnë ndërsa përpjekjet diplomatike për të rihapur ngushticën e Hormuzit dhe për të rikthyer negociatat mes Iranit dhe SHBA-ve kanë ngecur. Një marrëveshje e përkohshme e arritur në qershor u rrëzua muajin e kaluar pas sulmeve iraniane ndaj anijeve në

ngushticë dhe akuzave reciproke për shkelje të marrëveshjes. Pas kësaj, palët kanë shkëmbyer sulme dhe SHBA-ja ka rikthyer bllokadën ndaj porteve iraniane. Në Teheran, forcimi i figurave të vijës së ashpër po shihet si një sinjal se perspektivat për një marrëveshje afatgjatë janë zbehur. Udhëheqësi suprem Mojtaba Khamenei ka emëruar ish-komandantin e Gardës Revolucionare, Mohsen Rezaei, në një post të lartë të sigurisë. Për Perëndimin, shqetësimi kryesor është se një konflikt i ri mund të mos mbetet më i kufizuar në Lindjen e Mesme. Për Iranin, nga ana tjetër, kërcënimet për të goditur objektiva amerikane në Evropë duket se po përdoret si mjet parandalimi dhe presioni ndaj Uashingtonit, në përpjekje për të rritur koston e çdo sulmi të ardhshëm. Megjithatë, mbetet e paqartë nëse Teherani do të ishte realisht i gatshëm të ndërmernte sulme në territorin evropian, pasi një veprim i tillë do të rrezikonte një përshkallëzim shumë më të gjerë të konfliktit me SHBA-të dhe aleatët.

eg

EURO
GLASS

SAINT-DENIS
SEKURIT

PILKINGTON

Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Montim

Gratim

Perdorim

QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Rama: Historia po shkruhet, 'Prishtina 2030'

PRISHTINË, 19 GUSHT - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se ka udhëtuar drejt Tarantos në kuadër të përgatitjeve për Lojërat Mesdhetare 2030 të cilat do të organizohen në Prishtinë dhe Shqipëri.

Në "Facebook", Rama ka vlerësuar se organizimi i Lojërave Mesdhetare do t'i vendosë Prishtinën, Kosovën dhe Shqipërinë në hartën e madhe të sportit mesdhetar. "Historia po shkruhet. Prishtina 2030", ka shkruar Rama.

Ai ka theksuar rëndësinë e vizitës në Taranto për ta parë nga afër përvojën e organizimit të këtyre lojërave dhe për t'i marrë praktikat më të mira për përgatitjet në Prishtinë. "Sot, rrugës për Taranto. Me pa nga afër, me mësu nga përvoja e tyre dhe me marrë më të mirën

për atë që po ndërtojmë bashkë", ka shkruar Rama. Lojërat Mesdhetare 2030 pritet të jenë një nga ngjarjet më të rëndësishme sportive të organizuara në Kosovë, duke sjellë në Prishtinë sportistë dhe delegacione nga vendet e Mesdheut.

KOMBËTARJA U21 ZHVILLON STËRVITJEN E PARË PARA NISJES PËR "TARANTO 2026"

PRISHTINË, 19 GUSHT - Kombëtarja U21 e Kosovës ka zhvilluar stërvitjen e parë në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali në kuadër të përgatitjeve për pjesëmarrjen në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026". Kosova do të përfaqësohet në këtë turne me dy ekipe në futboll, Kombëtaren U21 të djemve dhe Kombëtaren U18 të vajzave. "Dardanët" e rinj, të udhëhequr nga përzgjedhësi Hekuran Kryeziu, para nisjes drejt Italisë do të zhvillojnë

edhe një seancë tjetër stërvitore. Kosova bën pjesë në Grupin B së bashku me Italinë, Shqipërinë dhe Algjerinë. Kryeziu ka vlerësuar se pjesëmarrja në Lojërat Mesdhetare është një përvojë e re për ekipin, ndërsa ka theksuar vështirësitë në përgatitje për shkak të datave që nuk përputhen me kalendarin e FIFA-s dhe UEFA-s. "E kemi një grup komplet të ri, një moshë të re. Stërvitja e parë ka qenë mirë dhe shpresojmë të kalojmë sa më mirë atje dhe të kemi rezultate

pozitive", ka deklaruar Kryeziu. Ai ka shtuar se, pavarësisht prej vështirësive për analizimin e kundërshtarëve, Kosova synon ta japë maksimumin në përballjet ndaj Algjerisë, Shqipërisë dhe Italisë. Optimizëm kanë shprehur edhe futbollistët e rinj. Rin Ahmeti ka vlerësuar intensitetin e stërvitjes së parë dhe ka thënë se synimi është kthimi nga Italia me medalje, ndërsa Adem Imeri ka theksuar dëshirën e ekipit për ta përfaqësuar Kosovën sa më denjësisht në këtë turne.

PATRICK VIEIRA EMËROHET PËRZGJEDHËS I SENEGALIT

DAKAR, 19 GUSHT - Patrick Vieira është emëruar përzgjedhës i ri i Senegalit, duke marrë për herë të parë në karrierën e tij drejtimin e një kombëtareje. Federata Senegaleze e Futbollit (FSF) e ka konfirmuar emërimin e ish-mesfushorit francez, i cili ka lindur në Dakar të Senegalit. Vieira do të pasojë Pape Thiaw, i cili u largua nga pozita pas eliminimit nga Kampionati Botëror i këtij viti në fazën e 1/16-ve. "Zotëri Patrick Vieira është trajneri i ri i kombëtares së Senegalit. Data e prezantimit zyrtar dhe hapat e ardhshëm për emërimin e tij do të bëhen me dije në një njoftim të mëvonshëm", është thënë në njoftimin e FSF-së. 50-vjeçari do ta marrë drejtimin e një kombëtareje për

herë të parë pas përvojave të tij në klubet e Anglisë, Francës dhe Italisë. Vieira ka drejtuar Crystal Palace në Ligën Premierë, ndërsa në Francë ka qenë trajner i Nice dhe Strasbourg. Ai pati gjithashtu një përvojë të shkurtër në Itali, ku drejtoi Genoan në Serinë A. Ish-mesfushori është një prej

lojtarëve më të suksesshëm në historinë e Francës. Vieira ishte pjesë e skuadrës që fitoi Kupën e Botës në vitin 1998 dhe Kampionatin Evropian në vitin 2000. Ai ka zhvilluar më shumë se 100 paraqitje me fanellën e Francës. Në nivel klubesh, Vieira njihet më së shumti për periudhën e tij tek Arsenali, ku ka zhvilluar mbi 400 ndeshje dhe ka fituar tre tituj të Ligës Premierë. Detyrat e tij të para me Senegalin do të nisin gjatë grumbullimit të ardhshëm të kombëtareve, ndërsa kampionët e Kupës së Kombeve të Afrikës të vitit 2021 do të fillojnë përgatitjet për edicionin e vitit 2027. Kualifikimet për këtë turne pritet të nisin që në muajin shtator.

BARCELONA TRANSFERON RODRIN NGA MANCHESTER CITY

Barcelonë, 19 gusht - Barcelona dhe Manchester City kanë arritur marrëveshje për transferimin e mesfushorit spanjoll Rodri i cili do të jetë pjesë e klubit katalanas deri më 30 qershor 2030. Rodri, i lindur në Madrid më 22 qershor 1996, konsiderohet ndër mesfushorët më të mirë në botë. Ai dallohet për inteligjencën taktike, qetësinë me topin, rikuperimin e posedimit dhe saktësinë në pasime. Karrierën e ka nisur tek akademja e Atletico Madridit, ndërsa është formuar te Villarreali, ku edhe ka debutuar në elitën e futbollit spanjoll. Në vitin 2018 ishte rikthyer tek Atletico, ndërsa një vit më vonë është transferuar te Manchester City. Me klubin anglez Rodri ka fituar trofe të shumtë, përfshirë tituj të

Premierë Ligës, FA Cup dhe UEFA Champions League në vitin 2023. Në finalen ndaj Interit ai kishte shënuar golin vendimtar që i siguroi Cityt trofeun e parë evropian. Rodri ka pasur gjithashtu rol kyç me kombëtaren e Spanjës, me të cilën ka fituar Euro 2024. Paraqitjet e tij në atë turne ia kishin siguruar edhe "Topin e Artë" në vitin 2024. Me transferimin te Barcelona, Rodri pritet të jetë një nga përforcimet më të rëndësishme të klubit katalanas.

Feneri i Muriqit ende në lojë për Champions

STAMBOLL, 19 GUSHT - Fenerbahçe dhe Lyon kanë barazuar 1-1 në ndeshjen e parë të play-off-it të Ligës së Kampionëve, duke lënë gjithçka të hapur për kualifikimin.

Lyon ka kaluar në epërsi me golin e Lois Opendas në minutën e 40, ndërsa Mason Greenwood ka barazuar rezultatin në minutën e 47. Të dyja skuadrat kanë pasur raste për ta fituar ndeshjen, por

rezultati nuk ka ndryshuar deri në fund. Ndeshja e kthimit do të zhvillohet javën e ardhshme në Lyon. Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, e ka nisur ndeshjen nga minuta e parë për

Fenerbahçen, ndërsa Romelu Lukaku ka qëndruar në bankën rezervë. Muriqi kishte dy goditje drejt portës, por njëra është pritur nga portieri, ndërsa tjetra është bllokuar nga mbrojtja.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Oriflame Cosmetics” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810523937 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Oriflame Cosmetics” L.L.C. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810523937 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Oriflame Cosmetics” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 810523937 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ariana Stuja shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 1.2. të gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Erdonita Gjeka shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Besim Byci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Olti Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat kl. 10.11.12 si dhe diplomën e SH.M. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Epikao Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.

- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.


- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail:contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com



Në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në bazë të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MFPT nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, në bazë të nenit 12 të Rregullores së marrëdhënies së punës nr. 1/1338 datë 14.11.2024, në bazë të Rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës nr. 1/1373, datë 22.11.2024 dhe pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur, Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, me datën : 20.08.2026, merr këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e vendit të lirë të punës

I. Titulli i vendit të punës:

Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit (një vend pune);

II. Lartësinë e pagës mujore për vendin e punës;

- Paga bazë bruto është 1.075,50 EUR, e cila rrjedh nga një koeficient prej 4.50, me vlerë monetare të koeficientit 239.00 €.
- I/E punësuarja përfiton edhe shtesë për përvojë pune, e cila llogaritet në masën 0.5% për çdo vit të përvojës së plotë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përfiton gjithashtu shtesën për shujtë të ngrohtë, sipas politikave të ndërmarrjes.

III. Përmbledhje e shkurtër të përshkrimit të punës, në të cilin përshkruhet qëllimi i vendit të punës, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë kryesore;

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të Ndërmarrjes brenda kompetencave të tij dhe në pajtim me dispozitat e L.PP;
- Në konsultim me të gjitha departamentet përgadit një plan vjetor të prokurimit;
- Siguron që mallrat , shërbimet dhe punët blihen në mënyrën më ekonomike, efikase dhe efektive;
- Për aq sa mundet, siguron se në specifikimet teknike nuk ka kufizime në konkurrencë;
- Këshillon njësitë kërkuese, për metoda dhe praktika përkatëse të prokurimit;
- Në bashkëpunim me udhëheqësit e njësive kërkuese,koordinon të gjitha dokumentet,specifikimet,paramasat,parallogaritë dhe vizatimet;
- Organizon dhe menaxhon aktivitetet e prokurimit;
- Rekomandon përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve;
- Participon në negociime të tenderëve dhe siguron rezultate të drejta;
- Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, shqyrton propozimin për kontratë të rekomanduar nga komisioni vlerësues;
- Pranon/refuzon rekomandimin e propozuar;
- Nënshkruan kontratat pas rikonfirmimit që informatat financiare nuk kanë ndryshuar;
- Kur ndodhin mosmarrëveshje dëme në mallra , dorëzime të tepërta ose të mangëta, dështim në performim ose komplikime tjera relevante, ruan të gjitha komunikimet dhe dëshmitë relevante të pranuar, bazuar në Kregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik;
- Pas raportimeve të menaxherëve të kontratës, përcjell kontraktorët të cilët kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre kontraktuale, në lidhje me kompensimet e duhura, likuidimin e dëmeve dhe aranzhimin e anulimit të kontratave;
- Raporton në baza vjetore në fund të secilit vit fiskal për kontratat e nënshkruara;
- Përgadit raporte javore dhe mujore me KE;
- Kryen detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës , si dhe detyrave të ngarkuara nga KE.

IV. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës;

- Diplomë universitare :fakulteti ekonomik,juridik,administratë publike apo të ngjashme;
- 5 vite përvojë pune profesionale në prokurim publik;
- 3 vite përvojë në pozita menaxheriale dhe të udhëheqjes;
- Të jetë i çertifikuar për prokurim publik;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e prokurimeve dhe ligjeve;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqjes të ekipit;
- Shkathtësi humlutese;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike në Microsoft Office;
- Të ketë etikë në punë dhe integritet

V. Specifikimi i dokumenteve/dëshmimeve përkatëse për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;

- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
- Kopje e letërnjoftimit; CV; Certifikata e lindjes. Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
- Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e Kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

VI. Informata nëse emërimi është me afat të caktuar apo të pacaktuar, dhe kohëzgjatja e periudhës provuese:

- Lloji i kontratës: Kontratë në kohë të caktuar për periudhë prej gjashtë (6) muajsh, me mundësi vazhdimi.
- Periudha provuese: 6 muaj, gjatë të cilëve, punëdhënësi dhe i punësuar mund të ndërpresin marrëdhënien e punës me njoftim paraprak prej 7 ditësh.

VII. Datën dhe orën e saktë të përmbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur nga data 20.08.2026 deri me datën 03.09.2026.

VIII. Mënyra e aplikimit në konkurs:

- Dokumentet e kërkuara: Të gjithë kandidatët duhet të skanojnë të gjitha dokumentet që kërkohen sipas pikës V dhe t'i dërgojnë ato, së bashku me kërkesën për punësim/aplikacionin, në adresën e-mailit: burimetnjerezore@pallatirinise.com.
- Kthimi i informacionit: Zyra e Burimeve Njerëzore do të sigurojë informacion për pranimin e kërkesave për punësim/aplikacioneve.
- Sqarime të tjera: Zyra e burimeve njerëzore e institucionit publik ofron sqarime të nevojshme për kandidatët lidhur me kriteret e konkursit publik gjatë fazës së aplikimeve.

IX. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:


- Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet nëpërmjet testimit me intervistim (testim me gojë).
- Kalueshmëria është arritja e së paku 55 pikëve nga të gjitha fazat e konkursit publik.

X. Kalendar i procedurës së rekrutimit:

- Pas mbylljes së afatit të konkursit, zyra e burimeve njerëzore do të verifikojë aplikimet brenda 7 ditëve dhe do të konfirmojë përmbushjen e kriterëve nga kandidatët.

XI. Shënimi për aplikacionet e dërguara pas afatit:

Aplikacionet e dërguara pas datës 03.09.2026 nuk do të shqyrtohen.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail:contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Na osnovu lana 8. Zakona o radu br. 03/L-212, clana 5. Administrativnog uputstva MFPT br. 01/2024 o regulisanju procedura konkursa u javnom sektoru, clana 12. Pravilnika o radnim odnosima br. 1/1338 od 14.11.2024, Pravilnika o unutanjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1/1373 od 22.11.2024, i nakon razmatranja podnesenog zahteva i dokumentacije, Izvrсни direktor J.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. iz Pristine, od : 20.08.2026, uzmite ovo:

JAVNI KONKURS
Za popunjavnje upraznjenog mesta

I.Naziv radnog mesta:

Odgovorni službenik za nabavke (jedna pozicija);

II.Mesecna plata za radno mesto;

- Bruto osnovna plata iznosi 1.075,50 sto je izvedeno iz koeficijenta 4,50 sa novcanom vrednoscu od 239,00€.
- Zaposleni takode ima koristi od bonusa za radno iskustvo, koji se obracunava po stopi od 0,5% za svaku godinu punog radnog iskustva, u skladu sa vazecim zakonskim propisima.On/ona takode ima koristi od bonuza za topli obrok, u skladu sa politikama kompanije.

III.Kratak rezime opisa posla koji opisuje svrhu posla, kao i glavne duznosti i odgovornosti;

- Odgovoran je za upravljanje svim aktivnostima nabavke Preduzeća u okviru svojih nadležnosti i u skladu sa odredbama ZJN;
- U konsultaciji sa svim odeljenjima, priprema godišnji plan nabavke;
- Osigurava da se roba, usluge i radovi kupuju na najekonomičniji, najefikasniji i najdelotvorniji način;
- U najvećoj mogućoj meri, osigurava da nema ograničenja konkurencije u tehničkim specifikacijama;
- Savetuje jedinice koje podnose zahteve o relevantnim metodama i praksama nabavke;
- U saradnji sa rukovodiocima jedinica koje podnose zahteve, koordinira sva dokumenta, specifikacije, količine, procene i crteže;
- Organizuje i upravlja aktivnostima nabavke;
- Predlaže sastav članova Komisije za procenu ponuda;
- Učestvuje u pregovorima o tenderima i obezbeđuje pravedne rezultate;
- Nakon završetka procesa evaluacije, pregleda predlog ugovora koji je preporučila komisija za procenu;
- Prihvata/odbija predloženu preporuku;
- Potpisuje ugovore nakon ponovne potvrde da se finansijske informacije nisu promenile;

IV. Opšti i specifični kriterijumi za posao;

- Univerzitetska diploma: Ekonomski, Pravni, Fakultet javne uprave ili slično;
- 5 godina stručnog iskustva u javnim nabavkama;
- 3 godine iskustva na rukovodećim i liderskim pozicijama;
- Sertifikovan za javne nabavke;
- Znanje i iskustvo u oblasti javnih nabavki i zakona;
- Komunikacione veštine, planiranje rada i vođenje tima;
- Istraživačke veštine;
- Sposobnost za obavljanje zadataka i rad pod pritiskom;
- Poznavanje rada na računaru u Microsoft Office-u;
- Posedovanje radne etike i integriteta

V. Specifikacija relevantnih dokumenata/dokaza kojima se dokazuje ispunjavanje opštih i specifičnih kriterijuma za posao;

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za posao;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih. Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome sa stranih univerziteta moraju biti notarizovane od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije i overene.
- Dokaz o radnom iskustvu/potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, sa navođenjem radnog mesta i trajanja angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog penzionog fonda, kao i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili obavezni da uplaćuju u ovu instituciju);
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starije od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak dostavljenih dokumenata.
- Kada dode do sporova, oštećenja robe, prekomernih ili nedovoljnih isporuka, neizvršenja ili drugih relevantnih komplikacija, čuva sve relevantne komunikacije i primljene dokaze, na osnovu Pravila i Operativnih smernica za javne nabavke;
- Prati izveštaje rukovodilaca ugovora, prati izvođače radova koji nisu ispunili svoje ugovorne obaveze, u vezi sa odgovarajućom nadoknadom, likvidacijom štete i dogovorom o raskidu ugovora;
- Izveštava godišnje na kraju svake fiskalne godine za potpisane ugovore;
- Priprema nedeljne i mesečne izveštaje sa Izvršnom komisijom;
- Obavlja i druge poslove vezane za opis posla, kao i poslove koje mu dodeli Izvršna komisija.

VI. Informacije o tome da li je imenovanje na određeno ili neodređeno vreme i trajanje probnog perioda:

- Vrsta ugovora: Ugovor na određeno vreme u trajanju od šest (6) meseci, sa mogućnošću produženja.
- Probni period: 6 meseci, tokom kojeg poslodavac i zaposleni mogu prekinuti radni odnos uz prethodno obaveštenje od 7 dana.

VII. Tačan datum i vreme zatvaranja konkursa:

- Konkurs je otvoren od 20.08.2026. do 03.09.2026

VIII. Kako se prijaviti na konkurs:

- Potrebna dokumenta: Svi kandidati moraju skenirati sva dokumenta potrebna pod tačkom V i poslati ih, zajedno sa zahtevom/prijavom za zaposlenje, na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinise.com
- Povraćaj informacija: Jedinica za ljudske resurse će pružiti informacije o prijemu zahteva/prijava za zaposlenje.
- Ostala pojašnjenja: Jedinica za ljudske resurse javne ustanove pruža potrebna pojašnjenja kandidatima u vezi sa kriterijumima javnog konkursa tokom faze prijave.

IX. Način evaluacije i kriterijumi bodovanja:

- Evaluacija kandidata će se vršiti putem intervjua testiranja (usmeno testiranje).
- Polaganje je postizanje najmanje 55 poena iz svih faza konkursa.

X. Kalendar postupka zapošljavanja:

- Nakon završetka roka za konkurs, jedinica za ljudske resurse će proveriti prijave u roku od 7 dana i potvrditi da kandidati ispunjavaju kriterijume.

XI. Napomena o prijavama podnetim nakon roka:

Prijave podnete nakon 03.09.2026 neće biti razmatrane.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L